



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 7043 / Prot:

2

Tiranë, më 7. 2. 2023

URDHËR

Nr. 122, datë 7. 2. 2023

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË MBROJTJES NR. 5, DATË 10.10.2022 "PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E REKRUTIMIT TË USHTARËVE/DETARËVE AKTIVË NË FORCAT E ARMATOSURA"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 5, të nenit 16, të ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të shkronjës "P", të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64, datë 26.06.2014 "Për pushtetet dhe autoritet e drejtimit të komandimit në Forcate Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 13 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

Në udhëzimin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 5, datë 10.10.2022 "Për procedurat dhe kriteret e rekrutimit të ushtarëve/detarëve aktivë në Forcat e Armatosura", të bëhen shtesa dhe ndryshime, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 6.1, kreu I, shkronja "ë", të riformulohet si më poshtë:

"Njësia Mjekësore Ushtarake e FA-së (NJMU), pranë Spitalit Universitar të Traumës, përgjigjet për kryerjen e kontrollit fiziko-shëndetësor të shtetasve kandidatë për ushtarë/detarë aktivë, në Qendrën Shëndetësore të Forcës Tokësore".

2. Pika 5, kreu i II, të riformulohet si më poshtë:

Për t'u rekrutuar në FA, të gjithë aplikantët duhet të plotësojnë disa standarte për gjendjen shëndetësore, gjendjen fizike dhe edukimin. Zhvillimi i konkurimit përfshin:

- ekzaminim shëndetësor;
- testim fizik;
- testim intelektual;

- testim psikologjik;
- testim profesional (vetëm për personelin e orkestrës frymore).

3. Pika 5.2.1 , kreu i II, të riformulohet si më poshtë:

Testimi fizik të kryehet pas kontrollit të ekzaminimeve shëndetësore. Ai ka si qëllim të verifikojë standardet fizike që kandidatët duhet të plotësojnë për t'u rekrutuar si ushtarë/detarë në FA.

4. Pika 5.5.1, kreu II, të riformulohet, si më poshtë:

Ekzaminimi shëndetësor i kandidatëve për ushtarë/detarë aktivë, kryhet nga personeli i Njësisë Mjekësore Ushtarake, para testeve, pranë Qendrën Shëndetësore të Forcës Tokësore dhe për kandidatët të cilët kanë nevojë për kontroll më të specializuar, kontrolli bëhet pranë Spitalit Universitar të Traumës. Ai kryhet me kandidatët sipas listës së dërguar nga QPR.

5. Pika 5.5.4, kreu i II, të riformulohet, si më poshtë:

Ekzaminimi shëndetësor kryhet në Qendrën Shëndetësore të Forcës Tokësore sipas afateve dhe listës së dërguar nga QPR.

6. Përgjigjen për zbatimin e këtij udhëzimi: komandantët e Forcave, komandanti i Komandës Mbështetëse, komandanti i AFA-së, komandantët e reparteve të varësisë të drejtpërdrejtë, Qendra e Personel-Rekrutimit, AISM-ja, Njësia Mjekësore Ushtarake, drejtoritë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së;

7. Ndjekin zbatimin e këtij udhëzimi shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


MINISTRI
Niko Peleshi
